



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0059

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuesë, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi -Anëtar I Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE Zahiri SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave” me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 16.03.2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e Zahiri SH.P.K., me nr. 2026/0059, e datës 26.01.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave”, me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, anulimi në munges të mjeteve buxhetore e inicuar nga AK - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, për aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave”, me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.11.2024 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i

mbeturinave”, me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 16,500,000.00 euro.

Me 08.01.2026 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është anuluar aktiviteti.

Me 12.01.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 16.01.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26.01.2026, OE Zahiri SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0059, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Zahiri SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Të pakënaqur me Njoftimin e datës 08.01.2026 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, në lidhje me aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave” Lot 2, Lot 3, Lot 4, Lot 5, me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616-24-230-2-1-1, brenda afatit ligjor konform nenit 109 të LPP-së, ushtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa paraqitet për shkak se Autoriteti Kontraktues – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS:

Në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, ndonëse kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe në Dosjen e Tenderit (DT).

Në mënyrë të kundërligjshme e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit, pasi paraprakisht në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga procedura, edhe pse kemi qenë tenderues i përgjegjshëm dhe në përputhje të plotë me kërkesat e NJK dhe DT.

Hyrje

Fillimisht paraqesim një pasqyrë të shkurtër për të kuptuar më lehtë ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit.

Në këtë procedurë, AK ka shkelur procedurat e parapara me Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregulloret e KRPP-së, pasi në vend që të na shpallte fitues të këtij aktiviteti, ka zgjedhur të

anulojë procedurën dhe më pas të vazhdojë me procedura të negociuara, duke shpërblyer me kontratë operatorë ekonomikë që nuk kanë aplikuar në procedurën e hapur.

Në procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, AK ka siguruar buxhet, ndërsa për ne që kemi ofertuar në procedurë të hapur është pretenduar mungesë buxheti. Kjo dëshmon qartë se AK ka shkelur parimet dhe rregullat e LPP-së, rregulloret e KRPP-së dhe praktikat e mira të prokurimit publik.

Pretendimet ankimore

Në kërkesën tonë për rishqyrtim pranë AK-së kemi paraqitur këto pretendime:

Autoriteti Kontraktues – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, në mënyrë të kundërligjshme, ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit, ndonëse ne kemi ofertuar me tender të përgjegjshëm në të gjitha lotet ku kemi marrë pjesë. AK ka qenë i obliguar ta vazhdojë procedurën deri në përfundim të suksesshëm dhe të publikojë njoftimin për dhënie të kontratës, e jo njoftimin për anulim.

Si arsye për anulim, AK ka përmendur mungesën e buxhetit dhe mosparashikimin e këtij aktiviteti në buxhetin e vitit 2026 dhe në kornizën afatmesme buxhetore, pa specifikuar dispozitën konkrete ligjore mbi të cilën mbështetet anulimi. Planifikimi buxhetor është detyrim ekskluziv i Autoritetit Kontraktues dhe nuk mund të bartet si përgjegjësi tek operatorët ekonomikë.

AK, në momentin e shpalljes së një procedure të prokurimit, duhet të ketë siguruar mjetet financiare ose parashikimin e tyre. Zyrtarët e prokurimit janë të trajnuar për LPP-në dhe duhet ta kenë të qartë se anulimi i procedurës lejohet vetëm në rrethana të përcaktuara shprehimisht me ligj.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së, i cili përcakton se autoriteti kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe të veprojë në mënyrë transparente, si dhe nuk duhet të ekzekutojë asnjë aspekt të prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ose diskriminon operatorët ekonomikë.

Gjithashtu është shkelur neni 59.4 i LPP-së, sipas të cilit një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e NJK dhe DT. Tenderi ynë ka qenë plotësisht në përputhje me këto kërkesa.

AK nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe nuk ka respektuar nenin 60, pasi kriteri për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, kriter që ne e kemi përmbushur.

Shkelja e nenit 62 të LPP-së

Me anulimin e këtij aktiviteti, AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së, pasi asnjë nga kushtet e përcaktuara në këtë nen nuk plotësohet.

Sipas nenit 62:

Anulimi lejohet vetëm kur ekziston një shkelje ligjore e pariparueshme, gjë që nuk është konstatuar në këtë rast.

Lejohet nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm e tejkalojnë buxhetin, fakt që nuk është provuar nga AK.

Për arsye objektive dhe të paparashikueshme, anulimi duhet të ndodhë para hapjes së tenderëve, ndërsa në rastin konkret është bërë pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Po ashtu, asnjë nga kushtet e nenit 43.5 të Rregullores për Prokurim Publik nuk është përmbushur. Janë paraqitur tenderë brenda afatit; tenderi ynë ka qenë i përgjegjshëm; nuk ka urdhër nga OSHP për anulim; nuk ka shkelje të konstatuar të ligjit; nuk ka gabim teknik të verifikuar nga KRPP.

Anulimi është bërë në mënyrë të kundërligjshme, duke keqpërdorur diskrecionin dhe duke tejkaluar kompetencat ligjore të AK-së.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim

Me datën 15.01.2026, AK ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim me një arsyetim formal dhe të pabazuar. AK është thirrur në nenin 43.7, ndonëse tenderi ynë nuk e ka tejkaluar buxhetin dhe madje kemi qenë të shpallur fitues paraprakisht.

Arsyetimi i AK-së nuk adreson pretendimet tona, nuk identifikon dispozitë konkrete ligjore që justifikon anulimin dhe nuk ofron prova që e mbështesin vendimin. Për rrjedhojë, vendimi është i pabazuar në ligj dhe në fakte.

Praktika e OSHP-së

Sipas praktikës së konsoliduar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, anulimi i procedurës pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave lejohet vetëm në rrethana të kufizuara dhe të argumentuara qartë. Mungesa e planifikimit buxhetor nuk përbën bazë ligjore për anulim, pasi planifikimi financiar është detyrim ekskluziv i Autoritetit Kontraktues dhe nuk mund të prodhojë pasoja në dëm të operatorëve ekonomikë.

Fakti që AK ka zhvilluar procedurë të negociuar për të njëjtin aktivitet dhe ka siguruar buxhet, ndërsa për procedurën e hapur ka pretenduar mungesë buxheti, dëshmon diskriminim dhe trajtim të pabarabartë. Për shembull, për pozicionin kryesor “grumbullimi dhe transporti i mbeturinave” ne kemi ofertuar me çmim 48 euro/ton, ndërsa përmes procedurës së negociuar është shpërblyer një OE tjetër me çmim mbi 170 euro/ton, duke dëmtuar buxhetin e komunës.

Interesi juridik

Ne, si Grup i Operatorëve Ekonomikë ankues, kemi interes juridik-material konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, pasi jemi të vetmit që kemi vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit. Operatorët e tjerë janë tërhequr vullnetarisht nga procedura.

Në këto rrethana, është dashur që ne të shpallemi fitues të këtij tenderi. Anulimi është përdorur si mjet për të shmangur përfundimin e procesit dhe për të anashkaluar ofertën tonë konkurruese.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është konstatuar se kërkesa është e lejuar, është paraqitur brenda afatit ligjor nga personi i autorizuar dhe nuk ekzistojnë

pengesa të tjera procedurale për shqyrtimin e saj. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet ligjore për të vazhduar me shqyrtimin merititor (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

“AK nuk e ka cekur se në bazë të cilit nen dhe të cilit ligj duhet të anulohet kjo procedurë, por vetëm ka përmendur mungesën e buxhetit dhe mosparashikimin e këtij aktiviteti në buxhetin e vitit 2026 dhe në kornizën afatmesme buxhetore. Në këtë rast shtrohet pyetja se kush duhet ta parashikojë buxhetin për AK-në – mos vallë operatorët ekonomikë? AK duhet t'i kryejë vetë këto obligime, pasi kjo nuk është përgjegjësi e operatorëve ekonomikë. Në momentin që shpall një procedurë prokurimi, AK duhet ta dijë qartë se procedura nuk mund të kthehet prapa pa bazë ligjore. Zyrtarët e prokurimit të secilit AK ndjekin rregullisht trajnime për LPP-në dhe duhet ta kenë të qartë se kur mund të anulohet një procedurë prokurimi sipas dispozitave të LPP-së.”

Sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, aktiviteti i prokurimit është anuluar me arsyetimin si vijon:

“Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës, e anulon aktivitetin e prokurimit për arsye të mungesës së buxhetit dhe mosparashikimit të këtij aktiviteti as në buxhetin e vitit 2026 dhe as në kornizën afatmesme buxhetore.”

Ky arsyetim, si i tillë, konsiderohet në përputhje me nenin 62 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPP-së, ku përcaktohet:

“1. Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet kur një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;

1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit.”

Po ashtu, arsyetimi i lartcekur konsiderohet në përputhje edhe me nenin 43.7, lidhur me nenin 43.5 nënparagrafi i) të Rregullores për Prokurim Publik (RRPP).

Nga sa u tha më sipër, është konstatuar se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Për rrjedhojë, kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 63.1.1 nënparagrafi b), lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 63.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 04.02.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë

shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0059, ndërsa me datë 16.02.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0059, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësit dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Zahiri SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0059 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimor:

Ankuesi, në emër të Grupit të Operatorëve Ekonomikë (GOE) Zahiri SH.P.K.; NITI-N SH.P.K.; Knalprofis Group SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K., ka paraqitur ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave – Lot 2, Lot 3, Lot 4, Lot 5”, i arsyetuar me mungesën e mjeteve buxhetore.

Në ankesën e drejtuar OSHP-së, ankuesi pretendon se me këtë vendim janë shkelur nenet 59, 60 dhe 62 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si dhe neni 43 i Rregullores për Prokurim Publik (RRPP).

Ankuesi pretendon se, në përputhje me nenin 59 të LPP-së, AK ka obligim të kryejë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kriterëve të përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Sipas ankuesit, oferta e tij ka qenë plotësisht e përgjegjshme dhe në përputhje me të gjitha kërkesat administrative dhe teknike.

Më tej, ankuesi thekson se, bazuar në nenin 60 të LPP-së, kontrata duhet t’i jepet tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, kur ky është kriteri i përcaktuar për dhënie të kontratës. Në këtë aspekt, ankuesi pretendon se ka dorëzuar tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët.

Sipas ankuesit, AK, në vend të vazhdimit të procedurës së vlerësimit, ka vendosur anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u bazuar në pretendimin për mungesë të mjeteve buxhetore, duke iu referuar nenit 62 të LPP-së, pa ofruar dëshmi të mjaftueshme mbi ekzistimin e kushteve ligjore për një anulim të tillë.

Në ankesë theksohet se, sipas nenit 62, paragrafi 1 të LPP-së, një aktivitet prokurimi mund të përfundojë pa dhënie të kontratës vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht me ligj, përfshirë situatat kur konstatohet një shkelje e pariparueshme ligjore ose kur të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale tejkalojnë buxhetin e AK-së.

Në rastin konkret, ankuesi pretendon se AK nuk ka konstatuar ndonjë shkelje të pariparueshme ligjore dhe as nuk ka argumentuar, me prova konkrete financiare, se ofertat e përgjegjshme tejkalojnë buxhetin në kuptim të nenit 62 të LPP-së.

Sipas ankuesit, arsyetimi për mungesë të mjeteve buxhetore është paraqitur në mënyrë të përgjithshme dhe deklarative, pa u shoqëruar me analizë konkrete financiare dhe pa referencë të qartë ndaj rrethanave faktike që do ta bënë të pamundur vazhdimin e procedurës.

Ankuesi thekson se anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në një fazë të avancuar të procedurës, përkatësisht pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave, duke cenuar pritshmëritë legjitime dhe sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Gjithashtu, ankuesi pretendon se planifikimi dhe sigurimi i mjeteve financiare për realizimin e aktivitetit të prokurimit përbëjnë përgjegjësi të AK-së, dhe se mungesat eventuale buxhetore nuk mund të transferohen si barrë mbi operatorët ekonomikë, të cilët kanë vepruar në mirëbesim.

Më tej, ankuesi pretendon se pas anulimit të procedurës së hapur është zhvilluar procedurë e negociuar për të njëjtin aktivitet, çka sipas tij krijon mungesë konsistence në arsyetimin e mungesës së mjeteve buxhetore.

Sipas ankuesit, me këtë veprim janë cenuar parimet themelore të LPP-së, përkatësisht barazia në trajtim, transparenca dhe proporcionaliteti.

Ankuesi konsideron se anulimi i aktivitetit të prokurimit i ka shkaktuar dëme materiale, përfshirë kostot e përgatitjes së ofertës dhe sigurimin e tenderit.

Për të gjitha arsyet e lartcekura, ankuesi kërkon që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim dhe procedura të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues:

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit të lëndës “Menaxhimi i mbeturinave”, ankesës së operatorit ekonomik dhe përgjigjeve të AK-së, sqaron si në vijim:

Nga dokumentacioni i lëndës rezulton se aktiviteti i prokurimit është inicuar gjatë vitit 2024, me dërgimin e Njoftimit për Kontratë më 18.11.2024. Në momentin e inicimit, eksperti vëren se janë përmbushur kërkesat e nenit 9, paragrafët 2 dhe 5 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), përkatësisht është siguruar dhe dokumentuar Deklarata e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve, duke dëshmuar se në atë fazë ka ekzistuar konfirmim formal mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare.

Megjithatë, procedura në fjalë nuk është zhvilluar në mënyrë të zakonshme dhe të pandërprerë. Ajo ka qenë disa herë objekt ankimi dhe shqyrtimi gjyqësor, duke u tejzgjatur ndjeshëm nga viti 2024 deri në vitin 2026. Nga dokumentacioni i lëndës rezulton se më 29.05.2025 është nxjerrë Vendimi i Gjykatës Supreme (P.A. nr. 05/2025), ndërsa më 19.06.2025 është nxjerrë

vendimi pasues i Kryetarit të Komunës. Këto zhvillime kanë ndikuar në kontekstin juridik dhe institucional të procedurës.

Nga përmbajtja e emailit të Drejtoreshës së Drejtorisë së Financave, znj. Valbona Makolli (email i bashkëngjitur në raportin e vlerësimit, pa datë të specifikuar në dokumentacion), eksperti vëren se e njëjta, duke iu referuar vendimit pasues të Kryetarit të Komunës së Prishtinës nr. 14-400/04-88768/25, ka kërkuar iniciimin e veprimeve për anulimin e kontratës. Arsyetimi lidhet me faktin se buxheti i planifikuar për çështjet e mbeturinave, i reflektuar në Deklaratën e Disponueshmërisë së Mjeteve Financiare, ishte bazuar në të hyrat vetanake nga taksa e mbeturinave, të cilat, sipas këtij vendimi, nuk përbëjnë më kategori të hyrash buxhetore të Kryeqytetit, pasi inkasohen drejtpërdrejt nga KRM “Pastrimi” Sh.A.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, eksperti shqyrtues vëren se në platformën e-prokurimi, më 03.07.2025, është publikuar Formulari B54, me të cilin është shtyrë afati i hapjes së ofertave, ndërsa ofertat janë hapur më 09.07.2025. Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë më 08.01.2026, pra rreth gjashtë muaj pas hapjes së ofertave.

Mbështetur në rrjedhën e mësipërme, eksperti vlerëson se AK – Drejtoria për Prokurim do të duhej të ndërmerrte veprimet procedurale përkatëse në një moment më të hershëm, përfshirë edhe marrjen e vendimit për anulim para hapjes së ofertave, me qëllim të shmangies së krijimit të pasigurisë juridike për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Lejimi i hapjes së ofertave dhe vazhdimi i procedurës për disa muaj, për t’u përmbyllur më pas me anulim, ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e kësaj pasigurie juridike.

Në këtë drejtim, eksperti, më 05.02.2026, i është drejtuar AK – Drejtorisë për Prokurim me kërkesë për sqarime konkrete, duke kërkuar të sqarohet se pse procedura nuk është rishqyrtuar menjëherë pas zhvillimeve juridike të qershorit 2025, pse është lejuar hapja e ofertave në rrethana të ndryshuara dhe si arsyetohet konsistenca procedurale e veprimeve të AK-së gjatë kësaj periudhe.

Megjithëse nga përgjigjet e ofruara nga AK nuk rezulton se janë trajtuar në mënyrë të plotë të gjitha çështjet e ngritura, nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se anulimi është mbështetur në nenin 62, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPP-së, me arsyetimin e mungesës së mjeteve të lira për zotim për realizimin e kontratës.

Kjo rrethanë është konfirmuar përmes komunikimeve zyrtare ndërmjet Drejtorisë për Prokurim dhe njësisë kërkuese (Drejtoria e Shërbimeve Teknike), ku është theksuar:

“Në lidhje me kërkesën tuaj, ju sqarojmë se nuk i kemi në dispozicion mjetet e kërkuara për këtë projekt, prandaj ju lusim të procedoni me anulimin e procedurës së prokurimit me titull ‘Menaxhimi i Mbeturinave’.”

Megjithatë, eksperti vlerëson se çështja në këtë rast nuk lidhet vetëm me aspektin financiar, por edhe me ndryshimet e ndodhura gjatë zhvillimit të procedurës, përfshirë rrethanat financiare dhe juridike. Edhe pse reagimi procedural i AK-së meriton vërejtje lidhur me kohën e anulimit, mungesa objektive e mjeteve për zotim përbën bazë reale për anulim, pasi realizimi i kontratës bëhet i pamundur në kushtet reale financiare.

Në këtë drejtim, eksperti merr parasysh edhe praktikën vendimmarrëse të OSHP-së. Konkretisht, në Vendimin e OSHP-së nr. 2024/1163, datë 31.01.2025, Paneli Shqyrtues ka theksuar se, nëse

AK nuk disponon mjete të lira për zotim dhe realizimi i kontratës bëhet i pamundur në kushtet reale financiare, anulimi i procedurës mund të konsiderohet i arsyetuar.

Sa i përket pretendimit të ankuesit lidhur me procedurën e negociuar, eksperti vlerëson se kjo procedurë nuk mund të bëhet objekt krahasimi me procedurën e hapur të anuluar. Secila procedurë prokurimi ka rrjedhën dhe rrethanat e veta dhe, si e tillë, duhet të trajtohet në mënyrë të pavarur.

Përfundim i ekspertit shqyrtues:

Eksperti shqyrtues vlerëson se, në rrethanat kur AK nuk disponon mjete të lira për zotim, realizimi i kontratës bëhet i pamundur, çka përbën bazë objektive për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht, ankesa vlerësohet pjesërisht e bazuar, ndërsa rekomandohet që vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues ka analizuar datën e publikimit të këtij aktiviteti (sipas sistemit të e-prokurimit publikimi i procedurës 18.11.2024 - Kontratë publike kornizë – shërbime për 36 mujaj kalendarik), ku dhe ky aktivitet është trajtuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së me nr : 2024/1260 i datës 03.03.2025, vendimi nr. 2025/0253, vendimi nr. 2025/0622 i datës 25.07.2025 dhe vendimi nr. 2025/0680 i datës 09.10.2025 dhe bazuar në raportin e ekspertit shqyrtues dhe me qëllim që kjo lëndë mos ta humb qëllimin në kuptim të nenit 1 të LPP, dhe duke marrë parasysh të gjitha veprimet e palëve në procedurë të shpjeguara në mënyrë konkrete, vendos që ankesa të kualifikohet si pjesërisht e bazuar dhe ti jep të drejtën AK që të lenë në fuqi vendimin e saj, ngase thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret në munges të mjeteve buxhetore ka pasur të drejtë të vendosin anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues mbështet raportin e ekspertit shqyrtues kështu duke vendosur të mbetet në fuqi B58Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - anulimi në munges të mjeteve buxhetore , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Menaxhimi i mbeturinave", me numër të prokurimit 616-24- 11988-2-1-1.

Paneli Shqyrtues i bënë me dije AK-se që në të ardhmën do ta bëjë monitorimin lidhur me këtë aktivitet.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe vendosi sipas dispozitave ligjore të lartcekura, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjesërishtëm të ankesës të OE “Zahiri SH.P.K., vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I, dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Zahiri SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: